



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 7 Shkurt 2022

Nr: 47

VENDIM

PËR

CAKTIMIN E VENDNDODHJES SË DISA QENDRAVE TË VOTIMIT NË NDËRTESA PRIVATE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE NË BASHKITË SHKODËR, DIBËR, DURRËS, RROGOZHINË DHE LUSHNJË, TË DATËS

6 MARS 2022

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, neneve 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 93, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Referuar nenit 93, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 3, pikat 3 dhe 4, të udhëzimit nr. 1, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje.

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i propozon KQZ-së caktimin e qendrës së votimit në ndërtesë private, në pronësi të personave fizikë ose juridikë, duke paraqitur dy objekte alternative, planimetrinë përkatëse ose fotografi të ambientit, një përshkrim për lehtësitë që ofron objekti për zhvillimin normal të zgjedhjeve, si dhe të dhëna të tjera për efekt të plotësimit të kriterëve të



përcaktuara në kuadrin ligjor. Në rastet kur nuk është e mundur gjetja e një objekti alternativ, KQZ-së i paraqitet propozimi dhe të dhënat e kërkuara vetëm për një objekt.

Në KQZ janë administruar propozimet e kryetarëve të bashkisë Shkodër, Dibër, Durrës, Rrogozhinë dhe Lushnjë, për caktimin e vendndodhjeve të 128 (njëqind e njëzet e tetë) qendrave të votimit në ndërtesa private, me dokumentacion përkatës. Nga shqyrtimi i të dhënave në dokumentacionin e administruar rezulton se, propozimet përmbushin kriteret e përcaktuara në nenet 3 dhe 4, të udhëzimit nr. 1, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”.

1. Përgjithësisht propozohen të njëjtat vendndodhje të QV-ve, sikundër në zgjedhjet pararendëse:
 - për 8 QV, kryesisht bashkia Durrës, propozohet vendndodhje e ndryshme nga ajo e zgjedhjeve pararendëse, duke parashtruar shkaqe objektive për prishje të detyruar të godinave të 3 (tre) shkollave me vendim të këshillit bashkiak Durrës;
 - për 5 QV, propozohet vendndodhje e ndryshme nga ajo e zgjedhjeve pararendëse, duke parashtruar si arsye largimin e pronarëve të ndërtesave jashtë shtetit;
 - për 3 QV, propozohet një vendndodhje e ndryshme nga ajo e zgjedhjeve pararendëse, duke parashtruar si arsye ndryshim të destinacionit të ndërtesës ku ka qenë vendndodhja e QV në zgjedhjet e mëparshme.
2. Për të gjitha ndërtesat:
 - deklarohet se nuk përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike, kandidati, të afërmeve të tij, ose kanë shërbyer si zyra elektorale gjatë fushatës zgjedhore;
 - nuk janë shtëpi banimi.
3. Mjediset e propozuara për caktimin e vendndodhjes së qendrës së votimit plotësojnë kriteret teknike:
 - janë me sipërfaqe, përgjithësisht, jo më të vogël se 30 m²;
 - janë afër qendrës gjeografike të zonës së qendrës së votimit;
 - janë me ndriçim të mjaftueshëm;
 - janë, përgjithësisht, në katet e para të objekteve;

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 93 pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 3, të udhëzimit nr. 1, datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”,

V E N D O S I:

1. Caktimin e vendndodhjeve të qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore të kryejë menjëherë njoftimin me shkrim të zgjedhësve për vendndodhjen e qendrës së votimit, të caktuar me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Qarku	Bashkia	Nr.	Njësia Adm	QV	Vendndodhja e propozuar e QV
Shkodër	Shkodër	1	Shkodër	0252	Rruga Ali Pashë Gucia, Shkollë private Kolegji Turk
		2	Shkodër	0252/1	Rruga Ali Pashë Gucia, Shkollë private Kolegji Turk
		3	Shkodër	0253	Rruga Ali Pashë Gucia, Shkollë private Kolegji Turk
		4	Shkodër	0253/1	Rruga Ali Pashë Gucia, Shkollë private Kolegji Turk
		5	Shkodër	0283	Lagjia 10 Korriku, Medrese e djemve Haxhi Sheh-Shamia
		6	Shkodër	0284	Lagjia 10 Korriku, Medrese e djemve Haxhi Sheh-Shamia
		7	Shkodër	0285	Rruga Tepe, ambient shërbimesh Hydrocentrali Koman
		8	Shkodër	0285/1	Rruga Tepe, ambient shërbimesh Hydrocentrali Koman
		9	Shkodër	0287	Rruga Myzafer Pipa, Shkollë private "ABC" Suela Lezha
		10	Shkodër	0287/1	Rruga Myzafer Pipa, Shkollë private "ABC" Suela Lezha
		11	Shkodër	0288	Rruga Luguçezme, Shkollë private Medreseja Haxhi Sheh Shamia
		12	Shkodër	0289	Rruga Myzafer Pipa, Shkollë private "ABC" Suela Lezha
		13	Shkodër	0289/1	Rruga Myzafer Pipa, Shkollë private "ABC" Suela Lezha
		14	Shkodër	0290	Rruga Luguçezme, Shkollë private Medreseja Haxhi Sheh Shamia
		15	Shkodër	299	Lagja Salo halili, Shkolla ABC
		16	Shkodër	299/1	Lagja Salo halili, Shkolla ABC
		17	Shkodër	0307	Rruga Dom Ndre Zadeja, Shkollë Private "Miqesia"
		18	Shkodër	0307/1	Rruga Dom Ndre Zadeja, Shkollë Private "Miqesia"
		19	Shkodër	0224	Fshati Darragjat, ambient shërbimi Ded Shllaku
		20	Bërdice	0216	Bërdice e Mesme, ambient shërbimi Halit Ura
		21	Bërdice	0221	Trush, Ambient shërbimi Gjergj Patani
		22	Ana Malit	0202	Fshati Oblike, bar kafe Mirjon Shkambi
		23	Ana Malit	0208	Rruga Muriqan Shtuf , lokal Fahri Hoti
		24	Velipojë	0331	Rruga Kol Dashi, Bar kafe Gjovalin Shehu
Dibër	Dibër	25	Melan	1133	Fshati Begjunec, lokal privat Dashmir Murrja
		26	Peshkopi	1145	Lgj.Treg, ndërtesë private Pëllumb Lleshi
		27	Tomin	1152	Fshati Rashnapojë, ndërtesë private Refik Salkurti
		28	Tomin	1153	Fshati Pollozhan, ndërtesë private Bilbil Iskurti
		29	Tomin	1158	Fshati Brezhdan, ndërtesë private Rushit Domazeti
		30	Kala e Dodës	1185	Fshati Tejs, ndërtesë private Sitki Ahmati
		31	Kastriot	1186	Fshati Vakuf, ndërtesë private Riza Dida
		32	Kastriot	1199	Fshati Kastriot, ndërtesë private Haxhi Lleshi
		33	Muhurr	1213	Fshati Fushë Muhurr, ndërtesë private Shefqet Xhani
		34	Ishëm	1326	Shetaj, lokal Bajram Kurti
		35	Ishëm	1323	Ishëm, lokal Isa Sura
		36	Ishëm	1327	Ishëm, lokal Isa Tema
		37	Ishëm	1334	Ishëm, lokal David Gjika
		38	Manëz	1347	Manez, lokal Sefer Hoxha
		39	Manëz	1347/1	Manez, lokal Sefer Hoxha
		40	Sukth	1354	Lokal Astrit Avdullaj
		41	Sukth	1354/1	Lokal Astrit Avdullaj
		42	Sukth	1360	Sukth, ambient shërbimi Miranda Cela
		43	Sukth	1360/1	Sukth, ambient shërbimi Miranda Cela
		44	Sukth	1361	Sukthi i ri, ambient shërbimi Elmaz Losha
		45	Sukth	1361/1	Sukthi i ri, ambient shërbimi Elmaz Losha
		46	Sukth	1361/2	Sukthi i ri, ambient shërbimi Elmaz Losha
		47	Sukth	1362	Ambient shërbimi Lavdosh Hoxha
		48	Sukth	1362/1	Ambient shërbimi Lavdosh Hoxha
		49	Sukth	1363	Ambient shërbimi Xhetan Kurti
		50	Sukth	1363/1	Ambient shërbimi Xhetan Kurti
		51	Sukth	1363/2	Ambient shërbimi Xhetan Kurti
		52	Sukth	1364	Kullë, ambjent privat Ladimir Sulko
		53	Sukth	1364/1	Kullë, ambjent privat Ladimir Sulko
		54	Sukth	1365	Kullë, ambjent privat Ladimir Sulko
		55	Sukth	1365/1	Kullë, ambjent privat Ladimir Sulko
		56	Rashbull	1372/1	Lokal Kujtim Dema
		57	Rashbull	1372/2	Lokal Kujtim Dema
		58	Rashbull	1376	Xhafzotaj, lokal Isuf Milaqi
		59	Rashbull	1377	Arapaj, lokal Hysen Teshi
		60	Rashbull	1377/1	Arapaj, lokal Hysen Teshi
		61	Durrës	1413	Plazh, ambjent shërbimi Luan Ismalaj
		62	Durrës	1413/1	Plazh, ambjent shërbimi Luan Ismalaj
		63	Durrës	1413/2	Plazh, ambjent shërbimi Luan Ismalaj

Qarku	Bashkia	Nr.	Njësia Adm	QV	Vendndodhja e propozuar e QV
Durrës	Durrës	64	Durrës	1413/3	Plazh, ambjent shërbimi Luan Ismalaj
		65	Durrës	1414	Plazh, ambjent shërbimi Vasken Pironjani
		66	Durrës	1414/1	Plazh, ambjent shërbimi Vasken Pironjani
		67	Durrës	1434	Lokal Agron Musai
		68	Durrës	1434/1	Lokal Agron Musai
		69	Durrës	1463	Shkolla Ibrahim Kodra
		70	Durrës	1463/1	Shkolla Ibrahim Kodra
		71	Durrës	1464	Shkolla Ibrahim Kodra
		72	Durrës	1465	Shkolla Ibrahim Kodra
		73	Durrës	1465/1	Shkolla Ibrahim Kodra
		74	Durrës	1467	Rr.Adria, shkollë jopublike "Rilindja" Drini Hasani
		75	Durrës	1467/1	Rr.Adria, shkollë jopublike "Rilindja" Drini Hasani
		76	Durrës	1467/2	Rr.Adria, shkollë jopublike "Rilindja" Drini Hasani
		77	Durrës	1468	Rr.Adria, shkollë jopublike "Rilindja" Drini Hasani
		78	Durrës	1468/1	Rr.Adria, shkollë jopublike "Rilindja" Drini Hasani
		79	Durrës	1468/2	Rr.Adria, shkollë jopublike "Rilindja" Drini Hasani
		80	Durrës	1468/3	Rr.Adria, shkollë jopublike "Rilindja" Drini Hasani
		81	Durrës	1468/4	Rr.Adria, shkollë jopublike "Rilindja" Drini Hasani
		82	Durrës	1473	Lagja nr.1, shkollë jopublike "Albanian College"
		83	Durrës	1480	Lagja nr.1, shkollë jopublike "Albanian College"
		84	Durrës	1489	Lagja nr.1, shkollë jopublike "Albanian College"
		85	Durrës	1489/1	Lagja nr.1, shkollë jopublike "Albanian College"
		86	Durrës	1489/2	Lagja nr.1, shkollë jopublike "Albanian College"
		87	Durrës	1496	Lagja nr.8, lokal Artan Keçi
		88	Durrës	1496/1	Lagja nr.8, lokal Artan Keçi
		89	Durrës	1499	Lagja nr.8, lokal Kastriot Xhaferraj
		90	Durrës	1499/1	Lagja nr.8, lokal Kastriot Xhaferraj
		91	Katundi i Ri	1514	Sukth, lokal Mustafa Vrioni
		92	Katundi i Ri	1514/1	Sukth, lokal Mustafa Vrioni
93	Katundi i Ri	1524	Fshati Erzen, lokal Myslim Vrioni		
94	Katundi i Ri	1524/1	Fshati Erzen, lokal Pellumb Vrioni		
95	Katundi i Ri	1525	Lokal Bajram Qyrbja		
Tiranë	Rrogozhinë	96	Rrogozhinë	2229	Rruga Peqin, lagja 2, bar kafe Deshire Spahiu
		97	Rrogozhinë	2229/1	Rruga Peqin, lagja 2, bar kafe Deshire Spahiu
		98	Rrogozhinë	2230	Rruga Peqin, lagja 2, bar kafe Deshire Spahiu
		99	Rrogozhinë	2231	Stacioni i trenit, dyqan Shefqet Shera
		100	Rrogozhinë	2233	Ndertesat 6, blloku miqësia, dyqan Sokol Dyrmishi
		101	Kryevidh	2157	Kazie, lagja e re, bar kafe Qëndrim Muça
		102	Rrogozhinë	2224	Rruga Kavaja, lagja 1, bar kafe Bamir Kasa
		103	Kryevidh	2149	Fshati Domen, bar kafe Nexhmi Hoxha
		104	Lekaj	2213	Okshtun, lokal Ibrahim Bibi
Fier	Lushnjë	105	Lushnjë	2870/1	Lgj. "Loni Dhamo" shëtitore Palma, ambjent shërbimi Bashkim Licka
		106	Lushnje	2877	Lagja "Kadri Qystri", ambjent shërbimi, Kastriot Canka
		107	Lushnjë	2879	Lagja "Gafurr Muço", ambjent shërbimi Dilaver Hasanlliu
		108	Lushnjë	2878	Lagja "Gafurr Muço", ambjent shërbimi Ylli Bekaj
		109	Lushnjë	2878/1	Lagja "Gafurr Muço", ambjent shërbimi Ylli Bekaj
		110	Lushnjë	2857/1	Lagja "Kongresi Lushnjes", ambjent shërbimi Apostol Kondakciu
		111	Golem	2826	Fshati Golem i Vogël, ambjent shërbimi Berti Lulja
		112	Kolonjë	2968	Fshati Kolonjë, ambjent shërbimi Gramoz Çela
		113	Fier Shegan	2911	Fshati Koçaj, ambjent shërbimi Misi Kamxhiu
		114	Fier Shegan	2910	Fshati Qerret i Ri, ambjent shërbimi Shaban Musaku
		115	Fier Shegan	2917	Fshati Barbullinjë, ambjent shërbimi Qatip Topi
		116	Fier Shegan	2918	Fshati Jeta e Re, ambjent shërbimi Edmond Nezha
		117	Ballagat	2807	Fshati jazxhias, ambjent shërbimi, Zija Kuçi
		118	Ballagat	2809	Fshati Garrunjas, ambjent shërbimi Behar Hasalla
		119	Kolonjë	2974	Fshati Lumth, ambjent shërbimi Viktor Jongari
		120	Allkaj	2892	Fshati Çukas i Ri, ambjent shërbimi Tahir Bytyçi
		121	Allkaj	2895	Fshati Mazhaj, lokal Irakli Nushi
		122	Dushk	2817	Fshati Dushk Peqin, ambjent shërbimi Sherbet Dedej
		123	Dushk	2818	Fshati Dushk Peqin, lokal Flamur Gjata
		124	Krutje	2928	Fshati Zhym, ambjent shërbimi Adriatik Dallaku
		125	Krutje	2927	Fshati Fier i Ri, ambjent shërbimi Aristidh Gjermeni
		126	Hysgjokaj	2831	Fshati Hysgjokaj, ambjent shërbimi Besnik Xhepexhiu

Qarku	Bashkia	Nr.	Njësia Adm	QV	Vendndodhja e propozuar e QV
		127	Lushnjë	2864	Lagja "18 Tetori", ambjent shërbimi Agron Licka
		128	Lushnjë	2864/1	Lagja "18 Tetori", ambjent shërbimi Luan Licka